

INTERESIMI DHE NDËRHJRJA E AUTORITETEVE ITALIANE TË PUSHTIMIT MBI PROBLEMET FETARE NË SHQIPËRI

Në orientimet e veta strategjike Italia, në periudhën midis Dy Luftërave Botërore, i kushtoi vëmendje të veçantë depërtimit në Shqipëri në të gjitha fushat, politike, ekonomike, arsimore, kulturore, fetare etj. Dihet se përmes Shqipërisë Benito Musolini, diktatori i madh italian, që dominoi politikën e Romës në vitet 1922-1943, planifikonte depërtimin dhe zgjerimin e Perandorisë Italiane në Ballkan. Në këtë kuadër, problemet fetare dhe komunitetet fetare në Ballkan e veçanërisht në Shqipëri, e cila përbënte objektivin e parë të politikës ekspansioniste të Romës matanë Otrantos dhe karakterizohej nga ekzistenca e disa komuniteteve fetare, u vunë në fokusin e vëmendjes së qarqeve drejtuese italiane.

Nuk kemi kryer hulumtime në ato nivele që të japim detaje për kohën e saktë dhe intensitetin e kësaj vëmendjeje, që pa dyshim ekziston qysh para Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912, dhe vijoi në periudhën midis Dy Luftërave Botërore, por kemi në duar dokumente interesante të diplomacisë së Romës, që e pasqyrojnë atë në vitin 1939, domethënë menjëherë pasi Italia pushtoi Shqipërinë.

Njeri nga këto dokumente është një raport prej 11 faqesh, i cilësuar “rezervat”, me titull “Situata fetare në Shqipëri”*. Vëmendja kryesore në këtë raport gjithëpërfshirës për çështjen në fjalë, trajton disa çështje.

E para në trajtim është historia e përpjekjeve për të ngritur kishën unite në Shqipëri, një amalgamë kristiane, katoliko-ortodokse, që do të kishte për drejtues Papën e Romës. Të interesuar për këtë unifikim, qarqet e larta politike italiane ishin të vëmendshëm të gjenin prononcimet pro dhe kundra idesë në fjalë.

Duke e pasur fjalën për myslimanët, në raport, në sythin e parë që titullohet njësoj si titulli i përgjithshëm: “Situata fetare në Shqipëri”, thuhet:

“a) ... Nga ana tjetër ekziston një tendencë për të formuar një front unik me besimet e tjera kundër lëvizjes komuniste “pa Zot”, dhe kështu për të krijuar marrëdhënie më të mira me katolikët dhe deri tek diskutimi miqësor publik mbi çështjet fetare (“Zani i naltë”; organ i komunitetit mysliman, numri i Prillit 1936, artikulli; “Çfarë urdhëron Kurani”),

* *Archivio del Ministero degli Affari Esteri, Roma* (Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë), Fondi: Sottosegretariato degli Affari Albanesi, Anno 1940, Pacco 56.

b) *Greket skizmatikë janë më pak refraktarë ndaj aksionit misionar, të ndryshëm midis tyre përsa i përket ndjenjave fetare; shumë, për nder të grupit të tyre që mendojnë se është çnderuar nga paaftësia dhe padenjësia e klerit skizmatik, të tjerë për ndjenja patriotike.*

Pengojnë lëvizjen drejt bashkimit:

- propaganda grekofile,

- kisha skizmatike autoqefale, që imponohet nga regjimi dhe te gjitha grupet skizmatike shqiptare, jo vetëm për t'u larguar nga ndikimi i vendeve te huaja, por edhe për të ndaluar shkrirjen me katolikët, nga e cila do të kishte rezultuar një minorancë e krishtere shumë e fortë.

Sllavo-skizmatikët e Shkodrës, të detyruar të hyjnë tashmë nën kishën autoqefale, janë sot më shumë se kurrë kundër, për arsye interesi, gjuhe dhe ritesh. Duket sikur presin së shpejti të kenë peshkopin e tyre te ritit sllav, të riun Elia Banushi, që po përfundon studimet në Universitetin e Beogradit.

c) *Grupi grek-unit është ende shumë i papërmbushur dhe i penguar nga kisha autoqefale skizmatike.*

Më tej në raport figuron sythi:

“Të dhëna të shkurtra mbi konfesionet e ndryshme”, ku jepen të dhëna për vendndodhjen dhe përbërjen numerike dhe organizim kishtar të komunitetit katolik, atij myslimansynit, bektashi dhe ortodoks.

Të dhëna të shkurtra mbi konfesionet e ndryshme

Katolikët

Katolikët janë thujse tërësisht të vendosur në Shqipërinë e Veriut dhe në atë të Mesme. Pavarësisht numrit të pakët, janë një e dhjeta e popullatës së vendit, dhe kuadri i përgjithshëm misionar përfshin:

Arkidioqezat në Durrës

Arkidioqezat në Shkodër

Dioqezat në Alessio

Dioqezat në Sapë (Zadrimë)

Dioqezat në Pult

Abacia në Orosh

Myslimanët

Myslimanët kanë udhëheqësin e tyre të besimit, “Krye-myftiun”, në Tiranë. Nga ai varen, Seminari i kryeqytetit, nga i cili dalin murgjit e rinj, si edhe myftinj të që janë vendosur në qytetet kryesore: Shkodër, Durrës, Korçë, Berat, Gjirokastrë, Vlorë.

Midis myslimanëve, synitë, përbëjnë thujse shumicën e banorëve, ata që dikur njihnin autoritetin e Kalifit dhe që sot konsiderohen pjesa ortodokse e islamizmit. Bektashinjtë dhe halvetinjtë janë sekte.

Mungesa e të dhënave dhe statistikave të sakta nuk lejon njohjen e organizimit të tyre të brendshëm dhe numrin e anëtarëve. Mund – ndër të tjera – të thuhet që bektashinjtë janë sekt i njohur. Këta besimtarë jetojnë në objekte të ndërtuara në Shqipërinë Veriore dhe të Mesme, të quajtura “Teqe” dhe gëzojnë – për ndershmërinë, për respektin ndaj traditave të vendit, për mënyrën se si ndoqën ngjarjet politike që sollën pavarësinë e vendin – shumë kredit (besim, autoritet, respekt), sidomos në krahinat e jugut.

Myslimanët, e gjithashtu të krishterët ortodoksë, nuk kanë organizata misionare si ato katolike, që kanë për qëllim të propagandojnë fenë dhe ta mbajnë gjallë nëpërmjet mësimit të katekizmit dhe predikimeve.

Ortodoksët

Ortodoksët, thujse tërësisht të vendosur në Shqipërinë e Jugut dhe atë të Mesme, janë, siç është thënë, në total rreth 200.000, pra dyfishi i katolikëve.

Në të kaluarën ata njihnin autoritetin e Patriarkut grek të Konstandinopojës.

Më 1922, nën shtytën e nacionalizmit dhe të Imzot Fan Nolit, një Kongres i Ortodoksëve në Berat, u shpreh qartë për shkëputjen nga Patriarku dhe për themelimin e Kishës Autoqefale Shqiptare.

Por vullneti i tyre gjeti në praktikë shumë kundërshti në krerët autoritarë të klerit dhe në abstenimin e pjesës më të qetë dhe më të moshuar të besimtarëve, të cilët e mbanin veten të lidhur me traditat antike fetare të familjes. Kundërshtitë dhe dy revolucionet e vitit 1924, i fundit që solli edhe ndryshimin rrënjësor të regjimit, nuk i lanë mundësi krijimit të kishës autoqefale shqiptare.*

Në një pikë më vete në raportin “Situata fetare në Shqipëri” jepen të dhëna dhe për ndjekësit e kishës unite. Ndër të tjera në këtë pikë shkruhet:

*“...I respektueshmi edhe sot, Dervish Bej**”, që e këshilloi Papa Jorgjin të bëhej katolik. Papa Jorgji nuk hezitoi të pranonte sugjerimin dhe për ta vënë në praktikë, përdori Konsullatën Austriake në Durrës, duke arritur të*

* Është fjala për konfrontimet e armatosura të vitit 1924, që larguan dhe risollën në pushtet grupimin politik të kryesuar nga Ahmet Zogu.

** Është fjala për një nga figurat potenciale në Elbasan dhe në Shqipëri, Dervish Bej Biçakun.

mashtronte klerin katolik dhe vetë jezuitët, finalizoi kalimin në Kishën e Romës.

Por edhe pas këtij kalimi në unit aktiviteti i tij ishte negative, sepse qëllimi i tij i vetëm ishte të zhvaste asistencë/ndihmë.

Pas vdekjes së tij rreth 1928, vepra e unitizmit u ndërmor nga Imzot Pietro Scalpelli – italian – dhe në momentin e parë u duk që lëvizja do të zgjerohej me hapa të shpejtë, gjë që më pas nuk ndodhi. Me fondet e Legatës Mbretërore [të Italisë] u ngrit të 1929 në Elbasan një kishë.

Një syth tjetër i raportit i kushtohet Urdhrave fetare në Shqipëri, i cili titullohet: “Urdhra fetare shqiptare dhe italiane”.

Lidhur me katolikët në raport shkruhet:

URDHRA FETARE SHQIPTARE DHE ITALIANE

Nuk mund të flasim për urdhra fetare qartësisht të ndarë përsa i përket kombësisë, por në njëfarë mënyrë mund të jepet lista e mëposhtme:

- kleri shekullar – të gjithë shqiptare – përveç një peshkopi italian në Kuçovë (A.I.P.A.)
- kleri grek-unit: 2 shqiptare, 1 italo-shqiptar
- shoqëria e Jezusit (jezuitët): 41 italianë, 15 shqiptarë, 1 kroat.
- Murgjit e vegjël (franceskanë) të gjithë shqiptarë, përveç njërit me shtetësi gjermane.

Për “franceskanët” që numërohen rreth 100, “lazaristët”, “unitet”, “motrat stigmatine”, “engjëjt e mëshirës”, “selasianët” etj., thuhet:

Nga franceskanët vihet re një lloj ksenofobie, e kuptuar në sensin që, nuk duan të kontrollohen nga të huajt dhe kanë për synim të shfaqen të vetmit kontribues në kulturën dhe progresin e vendit të tyre.

Të bindur se propaganda, nëse e bërë mbi baza nacionale është e aftë të sjellë sukses dhe rendiment më të lartë, kanë qëllim të zgjerohen duke zëvendësuar misionet e tjera në jug; dhe qeveria qendrore natyrisht i favorizon. Në vizitën e fundit që Ati i Përgjithshëm i O.F.M., Leonardo Maria Bello, zhvilloi në Shqipëri, u vu re një konfirmim publik për sa u tha më lart, nga vëzhgimi i manifestimeve plot devotshmëri dhe respekt të autoriteteve shqiptare ndaj klerit të lartë.

Jezuitët: Mision i varur nga Provinca e Venecias. 61 subjekte, nga të cilët 26 priftërinj, të tjerët klerikë dhe laikë;

1 famulli: Tirana

1 kishë, jo e famullisë, në Shkodër, që ushtron detyra të shenjta të ndryshme;

1 mision i lëvizshëm me seli në Shkodër për predikimin e Misioneve të Shenjta midis katolikëve;

1 seminar papnor në Shkodër për formimin e klerit shekullar;

1 lice-gjimnaz në Shkodër (për momentin i limituar);

1 shkollë teknike tregtare dhe pedagogjike në Shkodër (për momentin e limituar);

1 elementare në Shkodër (për momentin e limituar);

1 gjimnaz me konvikt në Tiranë (për momentin e limituar);

1 elementare në Tiranë (për momentin e suprimuar)

1 jetimore në Shkodër

1 tipografi në Shkodër me dy revista:

“Leka” kulturore;

“Lajmtari” fetare

Organizata të ndryshme në Shkodër dhe Tiranë;

1 prift resident në Elbasan në shërbim të katolikëve latinë dhe grekëve-unitë

LAZARISTË: rezidenca në Korçë me një prift të vetëm italian për ushtrimin e shërbesave të ndryshme të shenjta midis italianëve dhe shqiptarëve dhe vetë të huajve.

1 PRIFT ITALIAN rezident në Kuçovë

3 PRIFTËRINJ TË RITIT UNIT me kishë në Elbasan për Unitet.

MOTRAT STIGMATINE: 1 shkollë magjistrale me konvikt në Shkodër (për momentin e suprimuar)

1 shkollë pune në Shkodër

1 shkollë fillore në Tiranë (për momentin e suprimuar)

Shkolla të ndryshme fillore dhe kopështë fëmijësh në Shkodër, në Shirokë dhe rrethina (për momentin të suprimuara)

Organizata të ndryshme femërore.

ENGJËJT E MËSHIRËS:

*1 shkollë pune në Durrës;
 1 elementare në Durrës (për momentin e limituar)
 1 elementare në Tiranë (për momentin e limituar)
 Asistencë spitalëve civile dhe ushtarake shqiptare në Tiranë dhe
 spitalit të vogël dhe ambulancës italiane në Durrës;
 Asistencë fetare kolonisë italiane në Shijak*

SALESIANE: 1 jetimore me shkollë fillore në Shkodër (për momentin e limituar);

*1 shkollë pune në Shkodër (për momentin e limituar)
 Asistencë spitalit të vogël italian në Shkodër;*

*SERVITE: 1 kopësht fëmijësh në Shkodër (për momentin i suprimuar)
 1 kopësht fëmijësh në Tiranë (për momentin i limituar)*

MURGESHAT E MËSHIRËS SË KALLMETIT: asistencë famullisë.

MURGESHAT E MËSHIRËS SË ZAGREBIT: asistencë spitalit civil shqiptar në Shkodër.

*

* *

Në dosjen për probleme të fesë e komuniteteve fetare në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë, përkatësisht në “Nënskretariaton e çështjeve shqiptare” kemi veçuar edhe organizimin e komunitetit katolik në Shqipëri, të përmbledhur me 6 dioqesa që shtriheshin në 115 vendbanime:

LEGATA MBRETËRORE E ITALISË NË TIRANË
LISTA E FAMULLIVE KATOLIKE NË SHQIPËRI

Lista e famullive katolike ekzistuese në Shqipëri

I. Arkidioqezat e Shkodrës

- | | |
|----------------|-----------------|
| 1. Baiza | 16. Pentari |
| 2. Barbullushi | 17. Pulai |
| 3. Beltoia | 18. Recë – Lohe |
| 4. Berdica | 19. Renci |
| 5. Boga | 20. Riolli |
| 6. Bushati | 21. Shkodra |
| 7. Dajçi | 22. Selca |
| 8. Hoti | 23. Sheldia |
| 9. Jubani | 24. Shiroka |
| 10. Jushi | 25. Shkreli |
| 11. Kastrati | 26. Shllaku |
| 12. Kolaj | 27. Stajca |
| 13. Kukli | 28. Trushi |
| 14. Mazreku | 29. Vukli |
| 15. Oboti | |

II. Arkidioqezat e Durrësit

- | | |
|----------------|-------------------------|
| 1. Bazja | 12. Laçi |
| 2. Biza | 13. Lura |
| 3. Blaj | 14. Miloti |
| 4. Delbinishti | 15. Perlati |
| 5. Dervendi | 16. Rështesi |
| 6. Durrësi | 17. Rrsheni |
| 7. Juba | 18. Selita |
| 8. Kmella | 19. Shna Prende (Skraj) |
| 9. Korça | 20. Tirana |
| 10. Kuçova | 21. Vlora |
| 11. Kurbini | 22. Zheja |

III. Dioqeza e Lezhës

- | | |
|--------------|-------------------|
| 1. Lezha | 7. Manatia |
| 2. Breg Mati | 8. Merqia |
| 3. Bulgri | 9. Plana |
| 4. Kakariqi | 10. Reia (Rubiku) |
| 5. Kallmeti | 11. Velia |
| 6. Kryeziu | 12. Zeimeni |

IV. Dioqeza e Mirditës

- | | |
|---------------|---------------------|
| 1. Blinishti | 9. Oroshi |
| 2. Kaçinari | 10. Qafamalit |
| 3. Kalivari | 11. Shëngjergji |
| 4. Kashnjeti | 12. Spaçi |
| 5. Korthpula | 13. Ungrei |
| 6. Fandi | 14. Vigu |
| 7. Mnella | 15. Gomsiqe |
| 8. Nerfandina | 16. Gryka e Gjadrit |

V. Dioqeza e Pulatit

- | | |
|-------------|-------------|
| 1. Curraj | 9. Prekali |
| 2. Dushmani | 10. Raia |
| 3. Giani | 11. Shala |
| 4. Kiri | 12. Suma |
| 5. Nikaj | 13. Thethi |
| 6. Palci | 14. Toplana |
| 7. Plani | 15. Shoshi |
| 8. Pogu | |

VI. Dioqezat e Sapës (Zadrimës)

- | | |
|---------------------|--------------|
| 1. Baba | 12. Iballa |
| 2. Berisha | 13. Kqira |
| 3. Blinishti | 14. Kodheli |
| 4. Qelza | 15. Komani |
| 5. Dajçi di Zadrima | 16. Kryeziu |
| 6. Dushi | 17. Laç |
| 7. Dardha | 18. Naraci |
| 8. Fira | 19. Nenshati |
| 9. Gjadri | 20. Pistulli |
| 10. Gramshi | 21. Troshani |
| 11. Haimeli | |

Është e ditur se shtetit i duhen informacione të shumta dhe të sakta për gjithçka, dhe mbi bazën e tyre organizohet puna qeverisëse. Në këtë sens interesimi i autoriteteve italiane të pushtimit, veçanërisht në vitin 1939, për situatën në Shqipëri, përfshi edhe të dhënat për fetë dhe komunitetet fetare janë të kuptueshme. Po çfarë synimi kishin qarqet e larta drejtuese të Perandorisë Italiane? Cila do të ishte politika e tyre dhe si mendonin ato të vepronin ndaj klerit dhe komuniteteve të ndryshme fetare në Shqipëri? Përgjigjen e këtyre pyetjeve na e jep një dokument tjetër në të njëjtën dosje i datës 18 shtator 1939. Përmbajtja e tij nuk ka nevojë për koment.*

*Ministria e Punëve të Jashtme
Nënsekretariati i Çështjeve Shqiptare – Zyra 1*

SHËNIM

...Kemi nderin të sjellim në vëmendjen tuaj këto çështje:

- 1. Luogotenenza e Përgjithshme në Shqipëri, për të thyer pikërisht këtë strukturë myslimane, po i jep rendësi të veçantë sektit bektashi, si më i madh në numër dhe më luftëtar.*
- 2. Krerët e kishës ortodokse lenë të kuptohet se kërkojnë kalimin e besnikëve të tyre në unitizëm. Luogotenenza vazhdon të lerë përshtypjen se nuk kërkon ta nxitojë këtë ngjarje, por në të vërtetë, sipas udhëzimeve të kësaj ministrie, po e favorizon në mënyrë të fshehtë.*
- 3. Pasi të arrihet bashkimi i katolikëve me ortodoksët dhe ndarja e prerë midis synive dhe bektashinjve, do të arrihet në pikën ku do të kemi ekuilibrin e duhur të grupimeve të ndryshme fetare në Shqipëri.*
- 4. Në vend, ndodhet tashmë një komision i Institutit Qendror të Statistikës, i cili gjatë regjistrimit të popullsisë, do të mbajë shënime edhe për çështjet e besimeve fetare.*

Romë, 18 shtator 1939

*Përzgjedhja, përkthimi, redaktimi
dhe pajisja me shënime nga:*

**Marenglen VERLI
Jorina VERLI**

